

Hapet Thirrja për Bursa në Programin Erasmus + në Universitetin e Aegean në Greqi

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Aegean në Greqi, në kuadër të programit Erasmus + të Komisionit Europian, për studentët e nivelit Master dhe PhD të UT-ës.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit *Master për Research*;
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit *PhD për Research*.

Kohëzagjatja e bursave:

- Shkëmbimi studentëve për *Research* (3 muaj)

Mbani parasysh se mobiliteti fillon me datë **1 Korrik** dhe përfundon me datë **30 Shtator**.

Fusha e studimit:

- Financë dhe Administrim

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (850 EUR në muaj për studentët)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Procedura e Aplikimit dhe Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

-CV (në gjuhën angleze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti;

-Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Bachelor (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Listë notash e nivelit Master (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Aegean lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në

Universitetin e Tiranës. Nëse ju nuk do të frektoni lëndë dhe nuk do të merrni kredite në universitetin pritës por do të shkoni vetëm për hulumtim atëherë duhet ta përcaktoni këtë gjë në dokumentin Learning Agreement

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti** dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf*

Dokumentet e nevojshme për aplikim për nivelin **Doktoraturë:**

- CV (në gjuhën angleze);
- Listë e publikimeve;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash doktorature;
- Letër motivimi + Përshkrim të temës së kërkimit;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);
- *Learning Agreement;

** Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Aegean lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit lëndët që

nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Nëse ju nuk do të frekuentoni lëndë dhe nuk do të merni kredite në universitetin pritës por do të shkoni vetëm për hulumtim atëherë duhet ta përcaktoni këtë gjë në dokumentin Learning Agreement.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf*

Afati për aplikim: 25 Maj 2017

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt, emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe universitetin në të cilin po aplikoni.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën:
iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!

**** Koordinatorët akademikë për firmosjen e Learning Agreement në nivel fakulteti.**

Fakulteti i Ekonomisë

Ervin Demo (zv/dekan për Kërkimin Shkencor dhe Marrëdhëniet me Jashtë)